




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA-KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 03-052/01-0042843/24
Data.
Data. 30.08.2024



Komuna e Skenderajt
Skupština Opštine Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Datë	30.08.2024
Nga	Zyrtari përgjegjës për monitorim dhe raportim Mirsad Gashi
Për	Kryetarin e komunës
CC	Agjencioni për Parandalimin e Korrupsionit
Lënda	Raportimi i Integritetit sipas Planit komunal të Integritetit Janar Qershor

Siç e dimë, vet hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit paraqet një formë të hapur të angazhimit dhe vullnetit për luftimin e dukurive negative dhe përmirsimin e shërbimeve, është emruar zyrtari për sinjalizim, zyrtarin për integritet dhe komisionin komunal për integritet, ashtu siç obligohemi nga Plani i Integritetit.

Në komunën tonë tashmë është miratuar i Plani i Integritetit. zyrtari për integritet dhe komisioni komunal për integritet kanë realizuar fushata vetëdijesuese dhe informuese, poashtu edhe përmes bisedave dhe njoftimeve si dhe inkurajimin përmes e-mail-it zyrtar, që të raportohen shkelje apo të propozohen fusha tjera të rrezikut.

Krahas angazhimit të lartëcekur, janë marrur vendime dhe veprime gati në çdo drejtori, si në vijim:

Sistemi i menaxhimit financiar- Është rritur bashkpunimi mes drejtorive me OJQ e qytetarë konform obligimeve që rrjedhin nga Plani i Integritetit, janë mbajtur dëgjime mbi kornizën afatmesme buxhetore dhe mbi buxhetin.

Burimet Njerëzore- Janë realizuar trajnime online për zyrtarët e personelit dhe stafin tjetër, janë hartuar dhe kompletuar dosjet për të gjithë punonjësit, gjatë rekrutimit janë emruar komisione profesionale dhe adekuate, vlerësimi i punonjësve bëhet sipas meritokracisë, poashtu është hartuar plani i trajnimeve.

Auditimi- Është rritur bashkpunimi në mes zyrës së auditimit dhe drejtorive komunale, janë realizuar 2 auditime të brendshme, është publikuar plani dhe raporti vjetor i zyrës, është emruar udhëheqësi dhe zyrtari.

Prokurimi- Janë rritur kapacitetet profesionale përmes trajnimeve, është rritur stafi, janë publikuar të gjitha kontratat e lidhura me operatorë ekonomik, janë emruar komisione vlerësuese dhe menaxherë të kontratave, vazhdimisht emrohen përgjegjës për kontrata, janë publikuar plani i punës dhe raportet e punës.

Transparenca- Janë publikuar vendimet e zyrës së kryetarit, memorandume bashkpunimi, raporte, procedura, njoftime dhe shpallje në ueb-faqe, poashtu kemi pasur edhe 27 kërkesa për çasje në dokumente publike..

Ngacmimi seksual- Është hartuar Kodi i Etikës

Gjedozi dhe Kadastër- Janë publikuar raporte, janë mbajtur trajnime për stafin, ruhen dhe mirëmbahen të dhëna dhe statistika sipas obligimeve ligjore dhe atyre që rrjedhin nga Plan i Integritetit.

Inspeksioni- Janë realizuar trajnime online për stafin, janë realizuar inspektime në vendet e ndërtimeve, dhe inspektime tjera sipas nevojës.

Arsimi- Nuk ka pasur raste të braktisjes së shkollimit, janë realizuar disa pagesa si paga përcjellëse dhe jubilarë për mësimdhënësit e pensionuar, në komisionin për ndarjen e bursave janë përfshirë edhe Ojq, janë emruar komisione profesionale gjatë rekrutimit të stafit dhe janë realizuar procedura transparente.

Shërbimet Publike- Është publikuar plani i punës, janë realizuar trajnime për stafin, është rritur niveli i ofrimeve të shërbimeve publike, ka vazhduar paisja me kontenjerë në fshatra si dhe mirëmbajtja e hapsirave publike dhe gjelbruese në qytet, gjatë procedurave janë emruar komisione profesionale.

Kulturë Rini dhe Sport- Është rritur stafi, janë mbajtur trajnime për stafin, është rritur bashkpunimi me Ojq, janë mbështetur Ojq-të financiarisht.

Shëndetësi dhe mirëqenie sociale- janë mbajtur trajnime profesionale për stafin, është rritur stafi mjekësor, është rritur niveli i ofrimeve të shërbimeve mjekësore, është miratuar Rregullorja për të Drejtat e Fëmijëve dhe Statuti i QKMF-se

Deri më tani kemi kemi pasur zero raste të cenimit të integritetit dhe korrupsionit të raportuara, poashtu zero raste të ngacmimit seksual dhe sjellje jo-etike si dhe zero raste të konfliktit të interes, zero propozime për fusha të reja të rrezikut. Bashkangjitur gjeni raportin tabular sipas *Udhëzuesit të ndryshuar/plotësuar të datës 19.08.2024*

Të dhënat

Raportimi i zbatimit

Nr	Tësht e rezikut	Pëshkrimi	Masa e propozuar	Njesia përgjigjës	Afati i realizimit	Veprimet e marra	Niveli i realizimit	Verifikimi
1	Drejtimi dhe menaxhimi institucional dhe financiar	Paqartësi në objektivat e institucionit, jomjafatueshëm informim për planifikimet financiare	Përfshijsa e politikave dhe objektiveve në Planin vjetor të Ekzekutivit informimi më i gjerë për takimet publike buxhetore	Zyra e Kryetarit	6 muaj	Janë përfshirë objektivat në Planin Vjetor të Ekzekutivit	Realizuar	<p>Plani https://kk.rks-gov.net/skenderaj/wp-content/uploads/sites/27/2024/01/Plani-Vjetor</p> <p>Njoftimet publike buxhetore</p> <p>» Kalendarari i dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për KAB-in 2025-2027 (rks.gov.net)</p> <p>Njoftim-per-kalendararin-e-dëgjimeve-buxhetore-1.pdf (rks.gov.net)</p>

2	Burimet njerzore	Mungesa e trajnimave profesionale dhe Planit i trajnimave	Hartimi i planit të trajnimave, mundësimi i trajnimave	Zyra e personelit	6 muaj	Eshte hartuar plani yjetor i trajnimave, janë mundësuar trajnimave	Realizuar	
3	Auditimi i brendshëm	Mosfunksionaliz imi i auditimit të brendshëm	Funksionaliz imi i njësisë dhe certifikimi i stafit	Zyra e kryetarit	1 vit	Është funksionalizuar	Realizuar	
4	Menaxhimi i prokurimit publik dhe transparenca	Publikimi irregullt i kontratave si dhe Planit të Prokurimit dhe raporteve	Publikimi i planit/rapor tit dhe kontratave	Drejtoria e prokurimit	3 muaj	Është funksionalizuar	Realizuar	» Prokurimi (tks-gov.net)
5	Transparenca	Mospublikimi i rregullt i vendimeve të kryetarit	Publikimi i rregullt dhe periodik	Zyra e Informimit	1 muaj	Është adresuar	Realizuar	» Vendimet e Kryetarit (tks-gov.net)

6	Ngacmimi dhe profesionalizimi	Mungesa e Kodit te Etikës përkatësisht komisionit	Hartimi dhe miratimi i Kodit, emrimi i komisionit nga kuvendi komunal	Zyra e kryetarit	6 muaj	Eshte hartuar dhe miratuar Kodi, eshte emruar komisioni	Realizuar	» kodi etikës (rks-gov.net)
7	Gjeodozi Kadaster dhe prone	Mos publikimi raporteve periodike	Publikimi dhe informimi	Drejtoria e Kadastrit	6 muaj	Nuk eshte adresuar	Nuk eshte realizuar	
8	Inspektimi	Mos realizimi trajnimeve profesionale për stafin e ri	Realizimi dhe mundësimi i trajnimeve	Zyra e personelit	1 vit	Nuk eshte adresuar	Nuk eshte realizuar	
9	Arsimi	Mos mirëmbajtja e sistemit SMA per braktisjen e shkollimit	Caktimi i pergjegjsve	Drejtoria e Arsimit	3 muaj	Eshte adresuar	Eshte realizuar	EMIS Login (rks-gov.net)

10.	Shërbimet Publike	Mos publikimi i Planit i punës, ofrimi i shërbimeve	Publikimi i panit dhe raporte periodike	Drejtoria e shërbimeve publike	6 muaj	Eshte adresuar	Realizuar
11.	Kulture Rini e Sport	Mosrrijta e stafit ne dy vitet e fundit, publikimi i procedurave per mbështetje te Ojq-ve	Publikimi i procedurave	Drejtoria e Kultures / Zyra e Informimit	1 Muaj	Eshte adresuar	Realizuar -e-thirrise-per-OQJ-.pdf (rks.gov.net)
12.	Shendetesi dhe mireqenie sociale	Mosrishikimi i Statutit te Qkmf	Rishikimi dhe miratimi	Zyra e kryetarit/kuvendit komunal	6 muaj	Adresuar	Realizuar Vendimi-per-miratimin-e-Statutit-te-QKMF-se-Skenderaj-2024.pdf (rks.gov.net)